



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 48 prot.

Kamëz, më 13.042021

V E N D I M

Nr. 40 Datë 13 . 04 .2021

**PËRBËRJEN DHE DETYRAT E KËSHILLIT TEKNIK TË DREJTORISË SË
PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT.**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **13.04.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.35 Datë 12.04.2021**, në mbështetje të gërmës “k” të nenit 54, të ligjit 139/2015 “Përvetëqeverisjenvendore”; **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Të miratojë përbërjen dhe detyrat e Këshillit Teknik të Drejtorisë Së Përgjithshme të Investimeve, Projekteve Dhe Shërbimeve Publike.
2. Përbërja e Këshillit Teknik do të jetë si më poshtë vijon:
 - a. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Kryetar
 - b. Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Investimeve, Projekteve dhe Shërbimeve Publike. Anëtar
 - c. Drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Investimeve . Anëtar
 - d. Administratori i Ujesjellës Kanalizime Kamëz Sh.a. Anëtar
 - e. Drejtori i Ndërrmarjes së Pastrim Gjellbërimit dhe Treg. Anëtar
 - f. Drejtor i Drejtorisë së MTPM-së, Bordit të Kullimit+Pyjeve dhe Kullotave. Anëtar
 - g. Drejtor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH-së). Anëtar

3. Detyrat e Këshillit Teknik janë si më poshtë:

Miratimin e lejeve të ndërtimit për objektet me interes publik, të hartuar nga Bashkia Kamëz me specialistët e këtij institucioni ose me Operatorë Ekonomikë të kontraktuar nga ana e saj, në përputhje me dokumentat e planifikimit në fuqi në mbështetje të Ligjit Nr.107/2014, “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, sidhe VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimi të Territorit”, i ndryshuar.

4. Rolin e sekretariatit të Këshillit Teknik do e kryej Sektori i Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit .

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti**

